



**MINISTRIA E KULTURËS
DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE
SHKODËR**

Nr. 244/prot.
15

Shkodër më 20.07.2022

SHPLLJE PËR KONKURIM PUBLIK

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.581, date 28.8.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”, Urdhrit të Kryeministrit me nr.139, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”, Kodit të Punës dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm për Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër;

Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër shpall konkursin për pozicionin vakant provizor:

Përgjegjës sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse – Kategoria e pagës IV-a.

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për këtë pozicion:

1. Administron mjetet financiare që i vihen në dispozicion DRTK-së, sipas planit financiar;
2. Mban kontabilitetin financiar dhe bën azhornimin e tij me librat analitikë;
3. Përpilon përmbledhësen e listëpagesave si: borderotë, sigurimet shoqërore, etj;
4. Përpilon dhe paraqet çdo muaj pasqyrat financiare dhe i paraqet pranë institucioneve të përcaktuara shtetërore;
5. Raporton tek eprori dhe në Ministrinë e Kulturës për çdo lëvizje të fondeve buxhetore.

**KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN
E PRANIMIT DHE KRITERET E POSAÇME**

Kandidati duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë deri në moshën 35 vjec;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
6. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
7. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;

Kandidati duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

1. Të ketë arsim universitar të nivelit Bachelor dhe “Master Shkencor” në degën Financë Kontabilitet;
2. Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune në profesion në administratën publike;
3. Të ketë aftësi menaxhuese, organizative, komunikuese si dhe punë në grup shumë të mira;
4. Të njohë sistemet e fiskalizimit;
5. Të njohë Standartet Kombëtare të Kontabilitetit;
6. Të njohë legjislacionin fiskal në fuqi;
7. Të mbajë të gjithë korrespondencat me organet tatimore me institucionet shtetërore për pjesën financiare;
8. Të mbajë raport ditor për të gjithë transaksionet bankare, hedhjen e tyre në sistem, likuidimin e faturave;
9. Regjistrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.
- Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:
- Jetëshkrim (CV);
- Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen në zarf pranë Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër brenda datës 1 Gusht ora 9:00 .

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në DRTK Shkodër , brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën DRTK Shkodër do të shpallë në faqen zyrtare të DRTK Shkodër www.drtskshkoder.com, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Komisioni. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Komisioni individualisht, *nëpërmjet adresës së e-mail-it*, për shkaqet e moskualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës

për pozicionin si dhe njohuritë mbi Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 581, datë 28.8.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”.

- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në bazë të testimit nga Komisioni sipas një sistemi pikëzimi.

Kandidatët do të testohen dhe vlerësohen nga Komisioni me datë 3 Gusht ora 9:00 pranë DRTK Shkodër sipas pikëzimit:

- a) 40 (dyzet) pikë për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës;
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për përvojën profesionale të mëparshme;
- c) 10 (dhjetë) pikë për motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për pozicionin e punës:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, DRTK Shkodër do të shpallë fituesin në faqen zyrtare. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të DRTK Shkodër www.drtkshkoder.com.

